



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Nr.....Prot

Datë...../...../2023

RAPORTI

I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT

Periudha e raportimit: JANAR – PRILL 2023

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, dt.06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe të Udhëzimit nr. 22 datë 20.03.2018. “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, ligjit nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për periudhën Janar – Prill 2023 është me kod 1011237 dhe programi 09770 “Kërkimi Shkencor”.

Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2023, përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin korrekt të planit të buxhetit të vitit 2023 të miratuar, sipas artikujve, kapitujve në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative, granteve për financimin e projekteve , investimeve, duke siguruar një menaxhim dhe përdorim të fondeve buxhetore me transparencë, eficiencë dhe efektivitet të plotë.

Buxheti për shpenzimet korrente viti 2023

Për AKKSHI-në buxheti i alokuar për vitin 2023, është **281,000,000 (Dyqindetëdhjetënjë milion) lekë** me shkresën nr.79, datë 02.02.2023 të MAS

Me shkresën me nr. prot.2694/1, datë 21.02.2023, dërgohet nga MFE granti i mbartur për bursat CEEPUS në shumën 754.178 lekë.

Me shkresën me nr. prot.5340/1, datë 31.03.2023, dërgohet detajimi i grantit për shpërndarjen e bursave CEEPUS në shumën 3.000.000 lekë, si pakësim i zërit 604 (91106AC) “Projekte të bashkëpunimit të Universiteteve me Biznesi privat”

Me shkresën nr. prot. 6973//1, datë 25.04.2023, dërgohet nga MFE miratimi i rialokimit të buxhetit , si pakësim në llogarinë 604 (91106AC) në shumën 4.840.000 lekë, për kryerjen e pagesës së kuotave ndërkombëtare (605) Kap.08 në shumën 700.000 lekë dhe 4.140.000 lekë tek (602)Kap.08 për (1.500.000 lekë për konferenca dhe 2.640.000 lekë për financimin e Projektit BLUE AIR) shumë e cila do rimburohet nga projekti në buxhetin e shtetit.

Me shkresën nr. prot. 5212/2, datë 05.04.2023, të MFE pakësohet me shumën 80.000.000 lekë zëri 604(91106AB) “Financimi i Programeve Kombëtare e Ndërkombëtare”

Buxheti për shpenzimet kapitale viti 2023

Me shkresën nr. prot. 937/2, datë 16.03.2023 të MASR, dërgohet buxheti për shpenzimet kapitale në shumën 205.157.916 (Dyqindpesëmiljon e njëqindpesëdhjetëeshtatë mijë e nëntëqindëgjashtëmbëdhjetë) lekë. Nga kjo shumë me vendim Bordi Administrimi 1.000.000 lekë do përdoret për blerje pajisje kompjuterike për institucionin.

Në kapitullin 02 , shuma 5.300.000 lekë është dhënë si plan buxheti për projektet me financim të huaj.

Buxheti total i AKKSHI-së për vitin 2023 është 486.158 (në mijë lekë)

Buxheti i rishikuar është në shumën 406.912 (në mijë lekë) .

Emërtimi i Shpenzimeve	Buxheti v.2023 në 000/lekë	Buxheti v. 2023 i rishikuar në 000/lekë	Fakti Janar – Prill 2023 ne 000/lekë
Shpenzime totale	486.912	406.912	8.104

Realizimi i buxhetit për vitin 2023

Në 000/lekë

Emërtimi i zërave të Buxhetit	Buxheti 2023	Buxheti i Rishikuar 2023	Fakti Janar – Prill 2023	Në %
Paga	17.340	17.340	4.582	26.4%
Sigurime Shoqërore	2.820	2.820	769	27.2%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	5.000	5.000	1.818	36%
Transferime korrente të	255.840	168.000	0	0

brendshme				
Transferime korrente të huaja(08)		700	0	0
Mallra e shërbime kap.08		4.140	0	0
Projekte të infrastrukturës së Kërkimit Shkencor	205.158	205.158	0	0
Projekte të Kërkimit Shkencor Kap.02			0	0
Bursa CEEPUS	754	3.754	80	2.3%
TOTALI	486.912	406.912	7.249	

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) për periudhën janar- prill 2023 janë realizuar në masën 26.4 % dhe 27.2% në zbatim të strukturës, organikës së miratuar me VKM dhe vendimit për pagat në administratën shtetërore. Struktura akoma nuk është plotësuar pasi në fakt janë 14 punonjës nga 19 punonjës që ka struktura në plan. Një punonjëse është me leje lindje. Kemi dhe një punonjëse me kontratë (sanitare) mbi numrin organik.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602), është realizuar në vlerën 1.818 në mijë lekë, në masën 36%. Shpenzimet operative janë për pagesën e rojeve operative , për shpenzime postare , organizimin e nje konference per kerkimin shkencor, për pagesat e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve , për pagesat e anëtarëve të Bordit të Administrimit, për blerje kançeleri, udhëtime jashtë vendit etj.

Fondi për transferime korrente të brendshme në shumën 168.000 në mijë lekë.

Në bazë të vendimit nr.1, datë 03.03.2023, të BA –së ky fond është detajuar si më poshtë :

Financimi i projekteve ndërkombëtare 7.000.000 lekë

Financimi i PKKZH 141.000.000 lekë

Projekte të Universiteteve me Biznesin 20.000.000 lekë

Në 4- mujorin e parë 2023 nuk ka nisur ende financimi i projekteve fituese.

Transferime korrente të huaja në shumën 700.000 mijë lekë.

Fondi për bursat CEEPUS

Fondi për pagesën e bursave CEEPUS është 3.754 në mijë lekë . Personat që kanë përfituar si 4- mujor janë 5 dhe shuma e realizuar është 80 në mijë lekë , pra 2.3.%.

Projekte të infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në shumën 205.158 në mijë lekë.

Nuk ka filluar ende financimi i tyre.

Në kapitullin 02 (plani i financimit për projektet) është shuma 5.300.000 lekë , e cila nuk është shpenzuar .

Të ardhurat jashtë limitit nga UNICEF, SEREN 5, POLICY ANSWERS etj. çelje 8.904 në mijë lekë. Shtuar në muajin shkurt 2023 për projektin POLICY ANSWERS 7.174 në mijë lekë dhe plan gjithsej 16.078 në mijë lekë.

Pra nga të ardhurat jashtë limitit janë shpenzuar gjithsej **854 në mijë lekë** , mbetja për 2023 është **15.224 në mijë lekë** .

Aktivitete të Organizuara nga Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare

- SEKTORI I MARRËDHËNIEVE BILATERALE (DYPALËSHE)

Janar- Prill 2023

Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 607, datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)” si dhe Udhëzimin përkatës, Nr. 1, datë 30.11.2017 të Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë “Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e programeve të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik ndërmjet dy vendeve”.

Përgjatë periudhës Janar- Prill 2023 ky sektor u përqëndrua në realizimin e aktiviteteve që lidhen me promovimin e thirrjeve tekniko- shkencore bilaterale, hartimin e protokollit të ri bashkëpunimit me Kosovën, çeljen e thirrjes së re me Kosovën, shqyrtimin e dosjeve të projekt-propozimeve nga ana teknike dhe vlerësimin e projekt-propozimeve **ne kuadër të thirrjes bilaterale Shqipëri-Itali 2022-2024.**

Shqipëri-Kosovë:

Në vazhdim të detyrave funksionale Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale dhe në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8.03.2010, hyrë në fuqi më datë 1.12.2011, miratuar me VKM Nr. 265 datë 21.04.2010, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës”, u

hap thirrja e re tekniko-shkencore më datë 24.04.2023 dhe pritet të qëndrojë e hapur deri më 25.06.2023.

Ne kuadër të kësaj thirrjeje, paraprakisht u firmos dhe protokollit i bashkëpunimit për marreveshjen bilaterale më Kosovën, në takimin ndërministror të mbajtur në Kosovë, ku sektori i marrëdhënieve bilaterale u angazhua në hartimin e protokollit dhe më tej të dokumentacionit të nevojshëm për thirrjen e re.

Shqiperi- Itali:

Bazuar në Programin e Bashkëpunimit në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Shkencor ndërmjet Këshillit Kombëtar të Kërkimit të Italisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë më datë 19.05.2017 si dhe të Vendimit Nr. 1, datë 06.04.2022 “ për miratimin e komisioneve të vlerësimit teknik të projekteve në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit(AKKSHI).”, Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale, u angazhua në realizimin e procedurës së vlerësimit të projekt-propozimeve nga ekspertët e fushave përkatesë të vlerësimit. Në vijim u mblodhën dhe u përpiluan të dhënat e gjeneruara nga këto vlerësime, për të realizuar takimin e përbashkët me palën italiane për vëndojsne e 10-projektve fituese.

Më datë 20.03.2023, u mbajt takimi i përbashkët me përfaqësues nga AKKSHI dhe CNR të Italisë në të cilin u vendos për 10 projekt-propozimet të cilat do t'i paraqiten Bordit të Administrimit si projekte fituese në mbledhjen e ardhshme në mënyrë që të mërret vendimi për financimin e tyre.

Aktivitete te tjera:

Aktivitetet- “BLUE GROWTH SECOND WAVE ALBANIA” dhe gjithashtu eventit promovues i këtij aktiviteti , “PROMOVIMI I BLUE SECOND WAVE”. Në zbatim të Urdhërit nr.10 datë 27.01.2023, « Për Ngritjen e Grupit të Punës për Realizimin e Aktivitetit “Blue Growth Second Wave Albania”, në Kuadër të Projektit “Blue Growth Smart Adriatic Ionian S3”, Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale u angazhua në realizimin e dy aktiviteteve në kuadër të projektit Blue Air, përkatësisht në datat 31.01.2023 dhe 22-24.02.2023 pranë Tirana International Hotel, në këto aktivitete morrën pjesë rreth 100- kërkues shkencorë; përfaqësues IAL-sh; drejtues institucionesh kërkimore dhe IAL-sh nga shqipëria dhe më gjërë nga vëndet e përfshira si partnere në projekt.

Konferenca Kombëtare- “Konferencë Kombëtare, Bashkëpunimi Universitet-Biznes, një Nga Shtyllat E Modernizimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”.

Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale, u angazhua për planifikimin dhe organizimin e konferencës. Konferenca u zhvillua më datë 04.04.2023, pranë Hotel Plaza. Dhe në të morrën pjesë rreth 150-kërkues shkencorë; përfaqësues IAL-sh; drejtues institucionesh kërkimore dhe IAL-sh.

Raportet Vjetore:

Ne zbatim të Vendimit Nr 3 datë 30.11.2017 të Bordit të Administrimit të AKKSHI, cdo drejtues projekti është i detyruar të bëjë raportin e ecurisë së projektit në fund të çdo viti deri në përfundimin e projektit, qoftë ky një, dy apo tre vjeçar. Raporti vjetor bëhet për çdo projekt në veçanti dhe i paraqitet organit financues në djavorin e parë të muajit Janar të vitit në vazhdim.

Sektori i marrëdhënieve Bilaterale në kuadër të thirrjeve bilaterale Shqiperi-Kosove(2020) dhe Shqipëri-Itali(2021) , gjatë periudhës janar-prill 2023 ka kryer kontrollin teknik te raporteve vjetore të këtyre projekteve fituese.

- SEKTORI I MARRËDHËNIEVE MULTILATERALE

Aktivitete, ditë informative dhe trajnime të organizuara nga sektori i Marrëdhënieve Multilaterale (AKKSHI) mbi Programet Europiane për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin ne kuader të Horizon Europe, Euraxess, COST dhe Gender Equality Plans (GEP), Eureka:

Për periudhën Janar-Prill 2023 janë realizuar aktivitetet si më poshtë vijon:

1. 09 Janar 2023, takim informues prane zyrave te Drejtorise (DPN) mbi Horizon Europe,COST, , me perfaqesues te Institutit te Arkeologjise(Rudenc Ruka)
2. 17 Janar 2023, takim informues(Info day/Workshop) mbi GEP ne AKKSHI me Znj. Lindita Gjika ,qe eshte pjese e projektit Policy Ansëer, 12:30 – 13:30
3. 06 Mars 2023, takim informues ne zyrat e Agjencise mbi temen e GEP
4. 08 Mars 2023, takim informues(info day)ne zyrat e Agjencise mbi Eureka dhe programet Nderkombetare (Horizon, Cost, etj) me perfaqesues te SME-ve.
5. 16 Mars 2023, takim informues me perfaqesues nga GIZ dhe perfaqesues nga nje start-up inovatore per te gjetur mundesi financimi nepermjet Eureka dhe programeve te tjera europiane,13:00 – 15:00.

Aktivitete te tjera:

- Gjithashtu gjatë periudhës Janar-Prill 2023, u dërguan tek databaza e kërkuesve shkencor, thirrjet e hapura, programet e punës, ëëbinare, trajnime, konferenca të ndryshme shkencore dhe mundesi të reja të shpallura në kuadër të programeve të Horizon Europe, MSCA, etj.

-Po ashtu gjatë kësaj periudhe është bërë: raportimi i projekteve të ndryshme, përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Grantit në kuadër të projekteve, përdorimi i Funding and Tenders Portal, publikimi i vendeve të punës për stafet akademike tek Portali Euraxess Albania etj.

- Kërkuesit Shkencor, Stafet Akademike, po asistohen on-line dhe off line në lidhje me pyetje apo paqartësi të ndryshme që lidhen me hapat e aplikimit në Horizon Europe, COST, Euraxess, pjesa e buxhetit, marrëveshjet e grantit, raportimet etj.

- Në kuadër të Kapitullit 25, Zgjerimin e Zonës Europiane të Kërkimit ERA, Implementimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022 dhe Projektplanit Kombëtar për Integrimin European 2021 – 2023, Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale dhe Multilaterale jep kontribut të vazhdueshëm dhe po ndjek me vëmendje të vecantë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Projektet e Fituara:

Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale ka aplikuar dhe është partner fitues në disa projekte: Në këtë drejtim gjatë periudhës Janar-Prill ka realizuar implementin e Projekteve:

- **Titulli i Projektit:** Blue Growth Smart Adriatic Ionian S3 BLUEAIR
- **Koordinatori i Projektit:** Area di Ricerca Scientifica e Tecnologica di Trieste –Area Science Park
- **Kohëzgjatja e Projektit:** 01.12.2020– 31.05.2023
- **Project Nb:** 1229

- **Titulli i Projektit:** Euraxess Hubs
- **Koordinatori i Projektit:** Bay Zoltan Alkalmazott Kutatasi Kozhasznu Nonprofit Kft. (Bzn)
- **Kohëzgjatja e Projektit:** 1 Shtator 2021 – 1 Shtator 2022
- **Kodi i Brendshëm i Referimit:** 101035541

- **Projekti:** HORIZON-WIDERA-2021-NCP-IBA
- **Type of Action:** HORIZON-CSA
- **Akronimi:** NCP_WIDERA.NET
- **Current Phase:** Grant Management
- **Numri:** 101055286
- **Kohezgjatja:** 36 muaj

- **GA based on the:** HE MGA — Multi & Mono - 1.null
- **Data e fillimit:** 01 Prill 2022
- **Kostoja e parashikuar e projektit:** €8,000,000.00
- **Kontributi kerkuar nga BE-ja:** €8,000,000.00
-

- **Projekti:** HORIZON-CL3-2021-SSRI-01
- **Type of Action:** HORIZON-CSA
- **Akronimi:** SEREN5
- **Current Phase:** Grant Management
- **Numri:** 101073472
- **Kohezagjatja:** 36 muaj
- **GA based on the:** HE MGA — Multi & Mono - 1.null
- **Data e fillimit:** 01 Shtator 2022
- **Kostoja e parashikuar e projektit:** €2,374,666.25
- **Kontributi kerkuar nga BE-ja:** €2,374,666.00

- **Projekti:** HORIZON-WIDERA-2021-ACCESS-06
- **Type of Action:** HORIZON-CSA
- **Akronimi:** POLICY ANSWERS
- **Current Phase:** Grant Management
- **Numri:** 101058873
- **Kohezagjatja:** 48 muaj
- **Data e fillimit:** 01 Mars 2022
- **Kostoja e parashikuar e projektit:** €4,993,109.00
- **Kontributi kerkuar nga BE-ja:** €4,993,109.00

- **Projekti:** HORIZON-CL6-2021-BIODIV-02
- **Type of Action:** HORIZON-COFUND
- **Akronimi:** Biodiversa-plus
- **Current Phase:** Grant Management
- **Numri:** 101052342
- **Kohezagjatja:** 84 muaj
- **Data e fillimit:** 01 Tetor 2021

- **Kostoja e parashikuar e projektit:** €137,675,323.00
- **Kontributi kerkuar nga BE-ja:** €40,000,000.00

Drejtoria e Programeve Kombëtare

Sektori i Programeve Kombëtare ka realizuar:

1. Ndjekja e ecurisë së projekteve të financuara në kuadër të PKKZH.
2. Përgatitja e relacionit mbi projektet e financuara PKKZH.
3. Përgatitja e dokumentacionit për zëvendësimin e ekspertëve të dorëhequr në komisionet e vlerësimit të projekteve
4. Shpallja e Thirrjes për aplikim me projekte në kuadër të PKKZH 2023-2024.
5. Organizimi i ditëve informative mbi aplikimin me Projekte Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit për periudhën 2023-2024.
6. Shqyrtimi formal i projekt-propozimeve të depozituara në AKKSHI.
7. Monitorimi i projekteve të financuara në kuadër të PKKZH.
8. Raportime periodike (me shkrim) në kuadër të informacioneve që kërkohen për integrimin.
9. Pjesëmarrje dhe kontribute, në kuadër të bashkëpunimeve ndër-institucionale dhe ndërkombëtare.
10. Pjesëmarrje dhe kontribute në takime pune/workshop-e/konferenca online organizuar nga institucione vendase dhe të EU.
11. Kërkim dhe mbledhje të dhënash lidhur me modelet e sistemit të kërkimit shkencor në rajon dhe EU.
12. Pjesëmarrje në webinar /sesione trajnimi dhe plotësimi i dokumentit "Qualitative Assessment Questionnaire "Competitiveness in South East Europe: A Policy Outlook 2021, Science, Technology and Innovation Dimension".
13. Pjesëmarrje në webinarë//sesione trajnimi dhe kontribut në kuadër të nëngrupeve teknike të punës për plotësimin e "LGA (Screening list) Chapter 25: Science and Research".
14. Përgatitja e dokumentave dhe njoftimeve për popullimin e web të AKKSHI në kuadër të situatës COVID 19.
15. Shpërndarja e thirrjeve dhe njoftimeve të reja Horizon Europe lidhur me infrastrukturën e kërkimit shkencor në rolin e NCP.
16. Menaxhimi dhe popullimi i web dhe fb zyrtar të AKKSHI me lajme, njoftime, veprimtari.

Sektori i Teknologjisë dhe Inovacionit ka realizuar:

1. Ndjekja e ecurisë së projekteve të financuara në kuadër të PIKSH 2022.
2. Shpallja e Thirrjes për aplikim me projekte në kuadër të PIKSH 2023.
3. Shpallja e Thirrjes për aplikim me projekte në kuadër të PTI 2023
4. Organizimi i ditëve informative mbi aplikimin me Projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor për vitin 2023.
5. Organizimi i ditëve informative mbi aplikimin me Projekte të Teknologjisë dhe

- Inovacionit për periudhën 2023-2024.
6. Mbledhja e raportimeve nga IAL-të për ecurinë e relazimit të procedurave të projekteve të PIKSH 2022 dhe përgatitja e të dhënave mbi realizimin e tyre;
 7. Pjesëmarrje dhe kontribute, në kuadër të bashkëpunimeve ndërinsticionale dhe ndërkombëtare.
 8. Raportime periodike në kuadër të informacioneve që kërkohen për integrimin dhe të tjera;
 9. Pjesëmarrje dhe kontribute në takime të grupeve të punës/workshop-e/konferenca online organizuar nga institucione vendase dhe të EU.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Mirela MUÇA



ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"


VITI

2023

JANAR-PRILL

ne 000/leke

Emri i Grupit	AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT						Kodi i Grupit	09770
Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit								
Programet	(1) Fakti i vitit paraardhës 2022	(2) PBA Plan 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progressiv	(6) Fakti i Periudhes/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
Titulli								
11	Kerkimi shkencor	461.805,0	486.912,1	406.912,1	161.914,2	7.249,6	-154.664,6	
.....							
	Totali i Shpenzimeve te Ministrise	461.805,0	486.912,1	108.302,0	161.914,2	7.249,6	-154.664,6	
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit	1864	8904	16078,3	16078,3	854,0	-15.224,3	
	Totali	41.508,0	495.816,1	422.990,4	177.992,5	8.103,6	-169.888,9	

NEPUNESI ZBATUES	EMRI	VITORI	LENJA	NEPUNESI AUTORIZUES	EMRI	MIRELA MUÇA
	FIRMA				FIRMA	
	DATA	18.05.2023			DATA	18.05.2023

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

A.K.K.S.H.I.

2023

JANAR-PRILL

ne 000/leke

Emri i Grupit Programi	AKKSHI		(1) Fakti i vitit paraardhes 2022 Viti	(2) PBA Plan Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progressiv	Kodi i Grupit	
	KËRKIMI SHKENCOR							(6) Fakti	(7)=(6)-(5) Diferenca
Art.	Emertimi								
600	Paga		13.314,0	18.702,0	17.340,0	17.340,0	7.257,6	4.582,5	1011237
601	Sigurime Shoqërore		2.226,0	3.123,0	2.820,0	2.820,0		769,0	09770
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		4.496,0	7.180,0	5.000,0	5.000,0	94.656,6	1.818,0	
603	Subvencione								
604	Transferta Korente të Brendshme		17.980,0	220.200,0	265.840,0	168.000,0			
605	Transferta Korente të Huaja		600,0	600,0					
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ (kapitulli 01)		170,0						
602	Mallra e shërbime (kapitulli 08)					4.140,0			
605	Transferta Korente të Huaja (kapitulli 08)					700,0			
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ (kapitulli 08)		858,0		754,2	3.754,2			
Nen -Totali	Shpenzime Korrente		39.644,0	249.805,0	281.754,2	201.754,2	101.914,2	7.249,6	
230	Kapitale të Trupëzuara								
231	Kapitale të Trupëzuara		0,0	212.000,0	205.157,9	205.157,9	60.000,0		
232	Transferta Kapitale								
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem		0,0	212.000,0	205.157,9	205.157,9	60.000,0	0,0	
230	Kapitale të Trupëzuara								
231	Kapitale të Trupëzuara		0,0						
232	Transferta Kapitale								
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj		0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	
Totali	Shpenzime Kapitale		0,0	212.000,0	205.157,9	205.157,9	60.000,0	0,0	
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti		1.864,0		8.904,0	16.078,3	16.078,3	854,0	
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		41.508,0	461.805,0	495.816,1	422.990,4	177.992,5	8.103,6	
									-15.224,3
									-169.886,9

Drejtesesi i Ekipit Menaxhues të Programit	MIRELA MUÇA	Sekretari i Përgjithshëm	Emrit	Firma	Data
					18.05.2023

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

JANAR-PRILL 2023

Emri i Grupit	A.K.K.D.H.I	Kodi i Grupit	101237															
Programi	Komenti Shënuesor	Kodi i Programit	970															
nr 000/leke																		
Kodi	Emertimi i Produktit	Njësia matëse	Sasia Faktive (qapa vitit 2022)	Shpenzimet (qapa vitit 2022)	Kosto per Njesi (qapa vitit 2022)	Sasia (qapa planit te rimbuzur te vitit 2023)	Shpenzimet (qapa planit te vitit 2023)	Kosto per Njesi (qapa planit te rimbuzur te vitit 2023)	Shpenzimet (qapa planit te rimbuzur te vitit 2023)	Sasia Faktive (vitit 2023)Janar-qpil	Shpenzimet Faktive (viti 2023)Janar-qpil	Kosto per Njesi Faktive (ne fund te vitit 2022)	IV	Luhatjet ne Koston per Njesi		Komente		
														V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III		
A	Programet Kombetare	numer	46	71 010	1.544	50	141 000	2 820	141 000	0	0	0	0	-1.544	-2.020	-2.020		
B	Programet Njerkomb. te Bashkepunimit Shqiptar e Tabe	numer	38	27 912	735	10	7 000	700	7 000	0	0	0	0	-735	-735	-735	Nuk ka fajar ende shpenzuarje e granteve	
C	Programi i projektues se Infrastruktures	numer	20	152 485	7 974	25	204 158	8 166	204 158	0	0	0	0	-7 974	-8 166	-8 166		
D	Projekte te bashkepunimit Udhurimet shqiptar	numer	0	0	0	10	20 000	2 000	20 000	0	0	0	0	0	-2 000	0	0	
E	Programi i Buzave GEEBUE	numer	16	656	48	40	37 794	94	37 794	0	80	16	16	-32	-78	-78		
Treguesit e Performances/Produktet e realizuara nga perdorimi i te ardhurave jashte turr IRK																		
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia Matëse	Sasia e realizuar	Fakti i përmirësimit/progressit	Komente													
A	Njësia e punës së maturimit labencor			819.0														
D				0.0														

Emri i Drejtuesit i Elipit Menaxhues te Programit	Emri	MIRELA MUCA	Emri i Sekretarit	
	Firma		Firma	
	Data	10.02.2023	Data	

ANEKSI nr.4 "Raportimi i realizimit te objektivave te politikave te programit"

Periudha e Raportimit:

01.01.2023-30.04.2023

A.K.K.SH.J.

Kodi i Programit	9770	Emertimi i programit:	Kerimi Shkencor+(Zhvillim Teknologjik dhe Inovacioni)					Komente
Qellimi 1	Permiresimin e kuadrit ligjor per menaxhim cilësor te Kerkimit Shkencor							
Qellimi 2	Rritja e Financimit i kerkimit shkencor per Programeve							
Qellimi 3	Zgjerimi i bashkepunimit biznes-akademik e promovimi i H2020,ENN							
**Treguesit e performancës/Produktet:								
Objektivi 1.1	Kontributi teknik TAKKSH ne 3 Grupet e Punës të MASR per reformen e kerkimit Shkencor	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emeritimi i Treguesit te Performances** /Produktit	Niveli faktik i vitit 2022	Niveli i planifikuar ne vitin 2023	Niveli i rishikuar ne vitin 2023	Niveli faktik Janar-pillit 2023	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
			numri takimeve e asistence	0	0	0	0	0%
			numri i projekteve te financuara	46	50	50	0	92%
			numri i projekteve te financuara	38	10	10	0	0%
			numri i projekteve te financuara	20	30	30	0	0%
			numri i projekteve te financuara	0	10	10	0	0%
			numri i INFO DAY te realizuar	48	30	30	5	17%
			numri i raportimeve	2	3	3	1	33%
			numri i aktiviteve te realizuar	2	0	0	0	#DIV/0!
			numri projekteve	5	8	8	7	88%
			draft-metodologjia e hartuar	0				
			Baza e te Dhenave e hartuar	0				
			Modulet e hartuara	0				
			Numri i Bursave te alokuara	18	40	40	5	13%

* Objektivet e listuar jane ne funksion te permbushjes se qellimit te mesiperim te politikës. Nese specifikohet me shume se 1 Qellim, ai se bashku me objektivat e tij (psh Qellimi 2 me Objektivi 2.1; 2.2; etj) duhet te juten ne nje tabele tjetër te ngjashme, ne vazhdim te kesaj.

** Si tregues për vlerësimin e performancës së objektivave, krahas produkteve, shërbejnë edhe tregues të tjerë të matshëm të lidhur me to. Këto mund të jenë standarde të njohura të fushës; tregues statistikorë; indekse kombëtare e ndërkombëtare, etj.

*** Këtu listohen të gjithë treguesit e performancës, përfshi dhe produktet. Raportimi për produktet behet periodik dhe vjetor, ndërsa raportimi për treguesit e performancës mund te behet edhe vetem vjetor, nqs matshmeria e tyre periodike paraqet veshtiresi objektive.

Njeshkeshit, per ata tregues performance te cilet nuk vleresohen mbi baze vjetore por disa vjetore (psh vleresime ndekombetare te tilla si: OBI, PISA score, PISA score, PISA score, etc), si nivel i vitit paraardhes vendoset niveli me i fundit i regjistruar per ta.

Drejtesia i Ekipit Menaxhues te Programit	Emri	MIRELA MUCA	Emri	
	Firma		Firma	
	Data	18.05.2023	Data	
		Sekretari i Pergjithshem		

